



Nr 720 prot

Durrës më 06.05.2022

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në Durrës sot më datë 06.05.2022.

Unë **HARILLA A. ÇIPI** Përmbarrues Gjyqësor Privat me certifikatë nr. 244 pranë **Zyrës së Përmbarrimit Private "3L" shpk** pasi studiova dosjen përmbarrimore si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (11-2022-1449) 376 datë 25.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

KONSTATOVA

Se në datën 20.04.2022 Kreditori **Shoqëria "Black Scorpions" shpk** ka paraqitur pranë **Zyrës së Përmbarrimit Private "3L" shpk** kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv Faturat Tatimore Nr.100/2021 datë 01.12.2021; Nr.1/2022 datë 05.01.2022; Nr.36/2022 datë 01.02.2022 dhe Nr.74/2022 datë 01.03.2022 se bashku me Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (11-2022-1449) 376 datë 25.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me palë:

- **Kreditor** : **Shoqëria "Black Scorpions" shpk**
- **Debitor** : **Shoqëria "ARTCON" shpk me NIPT: L41407010C**
- **Me objekt** : **Kthim Shume**

Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv.

Me vendimin e Përmbarruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte kur për ekzekutimin e Urdhër Ekzekutimit duhet të kryhet bllokimi i aksioneve që zotëron debitori **Shoqëria "ARTCON" shpk me NIPT: L41407010C me administrator Z. Denist Ymeri** me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi.





# ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE 3L

Mbështetur në nenet 519, 527, 593 të Kodit të Proçedures Civile në nenit 36/3, dhe 53 i Ligjit 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

## URDHËROJMË

1. Vënien e masës së sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit **Shoqëria "ARTCON" shpk me NIPT: L41407010C me administrator Z. Denist Ymeri** me qëllim mostjetërsimin e tyre për tu shmangur nga detyrimi për ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutimit.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile.
4. Ky urdhër mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

ZYRË PËRMBARIMORE PRIVATE

"3L" SHPK

ADMINISTRATOR



Zyrë Përmbarimore Private "3L" sh.p.k , NUIS : L02401505K

Adresa : Lgj nr.3 . Sheshi "Liria" , Qendra Bisnesit Best Co, Kati i 7-të , pranë Bashkisë Durrës.

☎ 00355676452525 ; ✉ [zyrepermbarimore3l@gmail.com](mailto:zyrepermbarimore3l@gmail.com)

